



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep.	2-0/DPK	Nr Prot.	01-4343/13
Dep.		Br Prot.	
Dep.		Prot No.	
Nr. fletë	03	Dati:	17-12-2013
Broj stranica		Datum	
Nr. pages		Dati	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	18/12/2013
REFERENC-Ë:	AKK-DPK
PËR/ZA/TO:	z. Isa OSMANKAJ Menaxher i Sektorit për Prokurim në Komunën e Prizrenit
CC:	z. Ramadan MUJA Kryetar i Komunës së Prizrenit
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtësor i Agjencisë kundër Korruptionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin " Furnizimi me karburante për nevojat e Komunës së Prizrenit " <i>[Handwritten signature]</i>



I nderuari z. Osmankaj,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korruptionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me tenderin " Furnizimi me karburante për nevojat e Komunës së Prizrenit ", me nr. të prokurimit: 622 13 366 111, Agjencia kundër Korruptionit ofron këtë:

O P I N I O N

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues (në tekstin e mëtejmë A.K), që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin " Furnizimi me karburante për nevojat e Komunës së Prizrenit " në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Komuna e Prizrenit Sektori për Prokurim ka përgatitë " Njoftimin për Kontratë " me titull "Furnizimi me karburante për nevojat e Komunës së Prizrenit" me nr. prokurimi: 622 13 366 111, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt. 12.11.2013, në Procedurë të Hapur. Agjencia Kundër Korrupsionit ka identifikuar këtë procedurë prokurimi si rast për trajtim. Gjatë trajtimit të kësaj procedure të prokurimit në " Njoftimin për Kontratë " të publikuar në faqen elektronike të KRPP-së, më datë 12.11.2013, tek pikë III.2 e rubrikës " Kushtet për pjesëmarrje ", Autoriteti Kontraktues ka shpalosur këtë kërkesë tek pjesa Vërejtje: **është cekur që operatori ekonomik që oferton duhet pa tjetër të ketë pompë të karburanteve në Prizren dhe mundësishët edhe në Prishtinë (nuk pranohen operatoret ekonomik që nuk kanë pompa në Prizren dhe nuk pranohen marrëveshjet me operatoret ekonomik që kanë pompa në Prizren). Pompa duhet të punojë pa ndërprerë 24 orë. Operatori ekonomik është i obliguar që të ketë triska. Fituesi e ofertës është i obliguar që ta sigurojë bersen për karburante, (Faturat nga operatori ekonomik do ta kenë të bashkangjitur edhe deklaratën e Berses-Pagesat do të bëhen në këste). Furnizimi do të bëhet sipas nevojës se Komunës gjérë në realizimin e sasisë. Gjithashtu e njëjta pjesë është përshkruar edhe në " Dosjen e Tenderit ", që ka përgatitur A.K , pikë kjo e cila konsiderojmë se bie ndesh me ligjin në fuqi për Prokurimin Publik.**

Autoriteti Kontraktues me formulimin e kërkesave tek pjesa vërejtje e "Njoftimit për Kontratë" dhe " Dosjes së Tenderit ", ka bërë Diskriminim territorial në kundërshtim me Ligjin në fuqi për Prokurimin Publik ku thuhet se "Autoriteti Kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrëthanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik " , duke mos pranuar Operatorët Ekonomik që nuk kanë pompa në Prizren dhe duke mos pranuar marrëveshjet me OE që kanë pompa në Prizren Autoriteti Kontraktues ka bërë Diskriminim territorial .

Kriteret e lartë cekura në pikën III.2 të Rubrikës " Kushtet për pjesëmarrje " siç janë përshkruar në "Njoftimin për Kontratë " dhe " Dosjen e Tenderit " bazuar në legjislacionin e vendit dhe ligjeve në fuqi janë kritere diskriminuese dhe në këtë mënyrë eliminojnë konkurrencën e lirë duke favorizuar Operatorët e caktuar Ekonomik.

Gjatë ekzaminimit dhe krahasimit të dokumentacionit që ka ofruar A.K për këtë tender, gjithashtu është vërejtur se kërkesat e njësive kërkuese nuk janë përpiluar dhe lejuar në formë zyrtar, si dhe konkluzioni i cili është nxjerrë nga Zyrtari Kryesor Administrativ për lejimin e shpalljes se këtij tenderi nuk ka mbështetje në Ligj dhe akte nënligjore.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 69 Aftësia Teknikë dhe Profesionale, nenin 22 Inicimi i aktivitetit të prokurimit, nenin 7 Barazia në Trajtim Jo-

Diskriminimi të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042, dhe me nenin 9.1 të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj AKK rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe të shmangen praktika të tillë në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarrë.

Me respekt!



AKK
KOSOVA *